



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1003_08_13**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 16.09.2013.

në seancën e mbajtur më datë 24 tetor 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHE** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A.R. (emri i konsumatorit në shifër DPR – 14264, V.P.K.) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1003_08_13 i datës 21.08.2013.

Arsyetim

Parashtruesja e ankesës A.R. ka bërë kërkesë në KEK, me të cilën ka kërkuar nga KEK-u, që t'i kontestohet i gjithë borxhi i krijuar nga persona në mënyrë të kundërligjshme si uzurpator të banesës me shifër DPR - 14264 deri në periudhën e muajit Mars 2006.

Departamenti për Konsumator në KEK me datë 28.03.2013 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në Protokollin mbi dorëzimin e çelësave i lëshuar nga KPA ((Agjencia Kosovare e Pronave) me datë 06.10.2003.

Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 31.07.2013 ka nxjerr vendim duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që: 1) që konsumatorit A.R. t'i krijoj mundësinë e korrigjimit për mjetet e paguara në shifrën DPR - 14264 në vlerë prej 2,535.00 €, duke e futur në parapagim në shifrën DPR – 94085 për vlerën e njëjtë, pasi që e njëjta është detyruar ta paguaj këtë borxh pa bazë juridike; 2) që për borxhin e krijuar në shifrën DPR – 14264 sipas pikës 1 ta kërkoj përmes procedurës gjyqësore nga personat të cilat e kanë krijuar atë borxh të energjisë elektrike e të identifikuar nga KPA, por që duke mos e dëmtuar konsumatorin e tanishëm V.P.K.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 16.09.2013 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Baza e kundërshtimeve të KEK-ut të theksuara në ankesë është se parashtruesja e ankesës përveç një kontrate të shitblerjes nuk ka prezantuar asnjë dokument tjetër dhe e njëjta as që është legjitimuar



në këtë banesë si shfrytëzuese e kësaj banese dhe se e tërë evidenca në këtë shifër deri në muajin 08/2012 është udhëhequr në emër të R.P me shifër DPR – 14264 dhe se pas muajit 09/2012 evidentohet si konsumator V.P.K. Në ankesë po ashtu theksohet se parashtruesja e ankesës nuk ka pasur pengesa formale juridike që të regjistrohet si konsumator në këtë shifër.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24 tetor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se pretendimet e KKDFE-së se konsumatori nuk ka prezantuar asnjë dokument tjetër përveç kontratës së shitblerjes nuk qëndrojnë, pasi që konsumatori ka prezantuar edhe dokumente tjera nga institucionet tjera që konstatojnë se në atë pronë ka pasur persona tjerë të cilët kanë jetuar dhe kanë bërë shpenzime të energjisë elektrike në atë pikë matëse, e të cilët nuk kanë qenë pronar të banesës, si shkresa e Drejtoratit për Çështje Pronësore Banesore (HPD) – Prishtinë me datë 13.12.2002 në të cilën e vërteton se banesa e identifikuar me shifër DS001408 në HPD, është duke u shfrytëzuar nga një person me emër Sh.Xh po ashtu edhe protokollin mbi dorëzimin e çelësve i datës 06.10.2003 nga Drejtorati për Çështje Pronësore – Banesore (HPD) - Prishtinë i cili është lëshuar përfaqësuesit të autorizuar N.G.

Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës e posaçërisht analizimit të kontratës së shitblerjes së banesës të datës 30.03.2006 e cila kontratë është e lidhur në mes të R.P në cilësinë e shitësit të banesës dhe A.R në cilësinë e blerësit të banesës, ka vërejtur se nenit 5 i kontratës së shitblerjes thekson se, të gjitha obligimet të cilat e ngarkojnë pronarin lidhur me banesën deri me datën e nënshkrimit të kontratës i bart shitësi. Andaj me këtë rast Bordi i ZRRE-së konstaton se KEK, me rastin e pranimit të kësaj kontrate nga konsumatori ka qenë e obliguar të bëjë prerjen e borxhit dhe të njëjtin ta kërkojë nga personat që e kanë krijuar.

Sa i përket pretendimit të KEDS-it se pse konsumatori nuk e ka kthyer shifrën DPR – 14264 në emër të saj duhet theksuar se sipas analizave të bëra rrjedhës së energjisë aktive dhe transaksioneve të konsumatorit të shifrës DPR – 14264 është vërejtur se kjo pikë matëse nga periudha e vitit 2002 e deri në periudhën e muajit 03/2006 ka bërë shpenzim të energjisë elektrike në vlerë financiare prej 1,832.08€, ndërsa nga periudha 12/2002 e deri në periudhën 03/2006 shfrytëzuesit e kësaj prone shihet se nuk kanë bërë asnjë pagesë të energjisë elektrike. Si rezultat i mos pagesës së faturave të energjisë elektrike konsumatori është ngarkuar edhe me taksa tjera – dënime si njoftim për shkyçje si dhe për shkyçje të konsumatorit, me ç'rast është bërë një akumulim i borxhit të energjisë elektrike në vlerë financiare prej 2,535.00€ deri në periudhën kohore 04/2008 kur parashtruesja e ankesës është detyruar të bëjë pagesën e borxhit të energjisë elektrike në vlerë prej 2,535.00€, edhe përkundër faktit që e njëjta nuk e ka krijuar këtë borxh. Për këtë arsye edhe konsumatori për vite me radhë nuk ka mundur të kthejë shifrën e konsumatorit në emër të saj dhe të evidentohet në transaksionet e konsumatorit, pasi që KEK-u edhe përkundër kontratës së shitblerjes, përkatësisht nenit 5 të kontratës së shitblerjes ku definohet qartë se shpenzimet se kush i bartë, KEK-u i ka kërkuar konsumatorit këtë borxh, andaj edhe nuk mund të theksohet se konsumatori nuk ka pasur pengesa formale juridike që të regjistrohet shifra në emër të saj. Bordi i ZRRE-së konsideron se mosveprimet e marra nga ana e KEK-ut në atë periudhë kur është krijuar borxhi i energjisë elektrike dhe mos inkasimi i tij nga ana e shfrytëzuesve para lidhjes së kontratës nga konsumatori, nuk mund t'i ngarkohen pronarit të ligjshëm pasi që edhe dispozitat ligjore nuk e lejojnë këtë veprim.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.10.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1003_08_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të



të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar